

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” NË SHKUP
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ**



**B U L E T I N I
I
UNIVERSITETIT “NËNË TEREZA” NË SHKUP**

**Б И Л Т Е Н
НА
УНИВЕРЗИТЕТОТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ**

Nr.36 / Бр.36

**Shkup, 05 Gusht 2021
Скопје, 05 Август 2021**

**Botim i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup
Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје**

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së / Уредник на издавачката дејност на УМТ:
Prof. Dr. Aziz Pollozhani, rektor

Redaktor i Buletinit / Уредник на Билтенот:
Prof. Dr. Mustafa Ibrahim

Këshilli redaktues i Buletinit / Уредувачки одбор на Билтенот:
Prof.Dr. Mustafa Ibrahim
Prof. Inor. Dr. Rizvan Sulejmani
Prof. Inor. Dr. Zoran Trifunov
Mr.Bujar Kajolli

PËRMBAJTJA / СОДРЖИНА

1. Propozimi i rektorit, Prof. Dr. Aziz Pollozhani, për dhënien e titullit të nderit Doctor Honoris Causa4
2. Recension për dhënien e titullit të nderit Doctor Honoris Causa për Prof. Mateo Mandala6

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE / ФАКУЛТЕТ ЗА ТЕХНИЧКИ НАУКИ

1. Реферат за избор на наставник во сите наставно-научни звања во наставно-научната област **Фискална економија (50308)** – (Д-р. Арбреш Равени)9

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNOLOGJIKE / ФАКУЛТЕТ ЗА ТЕХНОЛОШКИ НАУКИ

1. Referat për zgjedhje të një mësimdhënësi në thirje docent nga fusha mësimore-shkencore **Tekstil (60707)** – (Mr. Emira Imeri)16

Në bazë të nenit 98 pika 16, nenin 184 paragrafi 2 të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/18) dhe nenit 334 dhe 336 të Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, parashtroj:

Propozim për ndarjen e titullit të nderit “Doctor Honoris Causa”

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. dr. Mateo Mandala t’i ndajë titullin e nderit “Doctor Honoris Causa”

Arsyetimi: Profesor Dr. Mateo Mandala është i lindur në vitin 1961 në Horën e arbëreshëve në Sicili. Ai është përgjegjës i Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Univeristetin e Palermos (Università degli Studi di Palermo). Profesori Mandala është ndër gjuhëtarët më të shquar të gjeneratës së re në botë . Albanistika dhe konteksti i gjuhësisë krahasimore dhe kultura arbëreshe në veçanti dhe ajo shqipe në përgjithësi janë fushat më të lëvuara shkencore të profesor Mandala-së .

Ai së bashku me prof. dr. Francesco Altimarin, është themelues i filologjisë moderne shqiptare, që sot në pikëpamjen metodologjike funksionon si një shkollë për të gjithë studiuesit e teksteve shqip. Trashëgimia gjuhësore dhe kulturore e arbëreshëve në Itali zënë një vend të posaçëm në aktivitetin e tij shkencor. Rezultatet e kërkimeve të tij, bashkë me ato të Profesor Françesko Altimarit janë referencë themelore ndërkombëtare në këtë fushë. Për veprimtarinë e tij shkencore, pedagogjike dhe intelektuale, profesor Mandala është vlerësuar në qarqe më kredibile ndërkombëtare dhe është zgjedhur Anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Shqipërisë, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës, si dhe ka marrë vlerësime dhe shpërblime të ndyshme nga institucione dhe asociacione me peshë ndërkombëtare. Për të ndëgjuar mendimet e tij në fushën e gjuhësisë, mendimit letrar dhe kulturologjik ai është ftuar nga disa universitete eminente botërore ku ka prezentuar dhe mbrojtur tezat e tij në këtë fushë tejet aktuale dhe të pahulumtuar deri sot plotësisht. Në fushat e hulumtimit në kuadër të kulturës shqiptare, literaturës shipe dhe gjuhësisë shqipe, Prof Mandala ka publikuar një numër të madh librash dhe kërkimesh që mund të përcillen në <http://https.unipa.it/persona/docenti/m/matt://wwweo.mandala/en/?pagina=curriculum> dhe https://www.adrionltd.com/en/3746_matteo-mandala

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Republikës së Shqipërisë e ka vlerësuar si:

“Albanolog i mirënjohur; historian dhe studiues i letërsisë arbëreshe dhe shqipe prej fillimeve deri në kohën e sotme, filolog e botues i shkrimeve dhe veprave shqip në disa periudha letrare; intelektual me interesa të gjerë dhe dijetar me ndihmesa origjinale në disa fusha të dijës kombëtare; përfaqësues i shquar i mendimit shkencor shqiptar në gjithë botën e sotme akademike-universitare.”

Profesori Mandala, e nderoi Universitetin “Nënë Tereza”, me pjesëmarrjen e tij në Konferencën tonë të parë “Kah zhvillimi i qëndrueshëm” (TSD), në vitin 2017, kur mbajti një ligjëratë tejet inspirative dhe mbresëlënëse për rrjedhat e gjuhësisë shqiptare sot. Ai

bashkë me Profesor Françesko Altamarin janë ndër mbështetësit e arsimit të lartë në gjuhën shipe në Maqedoninë e Veriut dhe të univeristetit tonë në veçanti.

Bazuar mbi synimin tonë për afirmim ndërkombëtar dhe promovimin e vlerave të vërteta akademike dhe shkencore që kanë vlera të pakontestueshme me dimensione universale si dhe mbi mundësitë ligjore dhe statutore të Univeristetit “Nënë Tereza” në Shkup, jam i bindur se përzgjedhja e Prof. Dr. Mateo Mandala-së për titullin honorifik “Doctor Honoris Causa”, do ta pasurojë prezencën tonë në shkallë ndërkombëtare dhe do ta afirmojë synimin tonë për tu bërë pjesë e një përfaqësie dinjitoze në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky akt, jam i sigurtë, që do të forcojë edhe bashkëpunimin dhe komunikimin shkencorë edhe mes dy Univeristeteve tona por edhe me bashkëkombasit tonë, me Arbëreshët e Italisë.

Propozuesi:

Prof. Dr. Azis K. Pollozhani d.v.

Rektor i UNT

Në bazë të nenit 184 nga Ligji për Arsim të Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr. 178/21), dhe në përputhje me nenet 334 dhe 336 të Statutit të Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup si dhe lidhur Vendimin e Drejtorisë Rektoriale të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, për formim të komisionit recensues numër 02-937/3 të datës 07.07.2021, Komisioni recensues për dhënien e titullit Doctor Honoris Causa Prof. Matteo Mandala, në përbërje: Akad. Ali Aliu, - kryetar, Akad. Françesko Altimari – anëtar dhe Prof. Dr. Aziz Pollozhani – anëtar, kanë nderin dhe kënaqësinë që Drejtorisë rektoriale dhe Senatit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup të ia propozojnë këtë

RECENSION

“...Vizioni modern dhe misioni i ri i albanologjisë u bë i mundur përmes tri cilësive të Mateo Mandala-së:

1.formimi i tij i gjerë dhe poliedrik intelektual, që tregon shtrirjen e madhe të interesave në lëmenjtë e albanologjisë;

2.karakteri civil dhe demokratik i angazhimit të tij kërkimor, që e vë shpesh në qendër të debateve të ndjeshme shkencore dhe qytetare;

3. Aftësia e tij për të punuar bashkë me studiues të tjerë, përmes një “rrjeti” lidhjesh të ngushta dhe të forta, miqësore dhe shoqërore, nëpër rrugët e reja të albanologjisë”, - thotë personaliteti tjetër arbëresh, në fushën e studimeve albanologjike, Francesko Altimari.

Citati i më sipërm përmbledh thelbin, natyrën shkencore të Matteo Mandalas, ndër të cilat shquhet vullneti, potencia, akribia deri rreptësi kërkimore që funksionon ngjashëm me institucion; në këtë fjalë timen, të shkurtër që titullari i këtij tempulli më nderoi ta sjell në ceremoninë festive për të nderuar Matteo Mandalan, me titullin Doktor Honoris Causa, dua ta nis nga e para, nga Arbëria, nga arbëreshët e Matteos dhe tonët, pjesë e trungut tragjikisht shkëputur dhe vendosur përtej detit Adriatik dhe që për afro gjashtë shekuj, arriti ta ruajë shpirtin shtresuar moteve, ta ruajë gjuhën e të parëve, për të rrëfyer golgotën, gjurmët, shenjat e lëna fletoreve, testamenteve, gojëpasgojëve; kështu shekull pas shekulli, formuar kopsht arbëresh, gjysmë punuar dhe gjysmë djerrinë; dhe vjen kopshtari i zellshëm dhe i hyn qilizmë, kopshtit etnik, kulturor, gjuhësor, letrar, që nga Lekë Matranga e Skiroit, Nikollë Filies dhe Nikollë Ketës, Dhimitër Kamardës dhe Da Radës deri tek Solano dhe Altimari.

Ky kopsht mbrujtur dhe pleksur mes vetes si një univers kompakt, arbëresh, që ka me vete identitetin, historinë, kohën, hapësirën, gjuhën, rrugën e ecjes, biografinë, artin, letërsinë, në korpusin e krijimtarisë shkencore të Matteo Mandalas. do të trajtohet nga kjo perspektivë, nga kjo multi-përbërje e universit arbëresh. Pa këtë qasje, kopshti nuk do të shfaqej i plotë, siç edhe ndodhi në shkencën shqiptare. Qasja studimore nga një gjerësi dhe lartësi e tillë, fare natyrshëm ka prekur ndjesinë e rishikimit të çështjeve nga historia e letërsisë shqipe; vepra e Lekë Matrangës, Doktrina Krishtere, e dyta pas Mesharit, vetëm njëzet-tridhjetë vite më vonë, poezia e parë arbërisht brenda kopertinave të saj, “Rilindja e vogël” arbëreshe në koloninë e Sicilisë, si dhe reflekse tjera, artikulluar bindshëm dhe me elegancë nga Matteo; nga kjo perspektivë do ta shohë veprën e De Radës, duke nisur nga çështje të artit letrar në përgjithësi dhe që nga fillimet, si ajo e raportit mes realitetit dhe artit, formimi letrar i autorit të Millosaos që bart në vete tërë përbërësit e universit arbëresh të përmendura këtu; qasje që më ndërmend debatin, mbase jo të përfunduar plotësisht mes prosë dhe josë së biografizmit (pozitivizmit...) në studimet mbi letërsinë; më ndërmend argumentet shpesh të shfrytëzuar të njërit

krah dhe tjetrit: Prusti si argument se pa jetën personale vështirë mund të përkapet tërësia, thelbi i letërsisë së tij dhe, Homeri, me mungesë totale të çfarëdo gjurme nga jeta e tij, nuk ia ka prekur majat sovrane të veprës së tij.

Pa dyshim që Matteo është lexuesi-studiuës më i vëmendshëm, më i thellë, më i mprehtë dhe më skrupuloz i veprës letrare të Ismail Kadaresë; dhe, me që fillimin e kësaj fjale e nisa duke thirrur në ndihmë F. Altimarin, po e citoj edhe në këtë kapitull të dytë: *“Vepra e Kadaresë pati jashtë Shqipërisë dy fate të mira: fati i pare është se gjeti një përkthyes të jashtëzakonshëm si Jusuf Vrioni që përmes frëngjishtes e bëri atë të njohur në mbarë botën; fati i dytë është se e gjeti sot një studiuës si Matteo Mandala që me këtë qasje kritike gjithëpërfshirëse i dëfton botës letrare vlerat e vërteta të letërsisë së tij madhore për here të pare jo copa-copa por me një vizion global dhe me një interpretim kritik të gjerë dhe të thellë që e lidh atë me majat më të larta të letrave dhe të letrarëve bashkëkohës...”*.

Është e saktë, studimit të Matteo Mandalas do t’i atribuohet merita e qasjes, e thellimit tekstologjik në prozën romanore të Kadaresë; është studim që nuk i ka shpëtuar nga vëmendja qoftë edhe një ndryshim rastësor, i parëndësishëm nga version i parë i romanit, dorëshkrim apo i botuar qoftë deri tek ai përfundimtar-i radhës për studiuësin; kërkim studimor që, nga kjo perspektivë, nga kjo gjerësi horizonti i ka mundësuar që, veprën e Ismail Kadaresë, ta perceptojë mozaik kuadrateve të lidhur, ku, çdo njëri në vete dhe i mëvetshëm, përmes indeve komunikojnë pandërprerë; perspektive kjo e synuar, që gjithashtu, i lejon të ajgëtojë detaje, shenja që mezi se shfaqen ose janë të fshehura dhe që vendin, enigmën e të cilave thua se e di vetëm autori, - pos Matteos; nga kjo lartësi atij nuk i shpëton as edhe ndërhyrja më e lehtë e autorit përmes tekstesh dhe ndërtekstesh dhe që, për një pjesë nuk e ka patur të qartë as vetë autori ngasjen, - dhembja e veshit të Pashit Osman, në krye të rrethimit të kalasë tek romani Rrethimi-(Kështjella), etj; i vetmi që e thellon, e plotëson strukturën e poetikës narrative të Ismail Kadaresë e cila në vete kopsitet brenda përmasave realitet imagjinatë, që, nga cilado qoftë perspektivë krijuese nisëse e shkrimtarit mbart me vete përmasat pleksëse mes jetës dhe vdekje, tokësore dhe qiellore, sa të dukshme e sa diskrete por të kudopranishme; qasjen e zërthimit dhe raportit të përbërësve kryesorë të poetikës së Kadaresë, Matteo e kundron nga majat universale të përvojës letrare narrative; sidomos raportet prore të hapura mes jetë-vdekjes, sferë ku Kadareja me lehtësi besueshmërie nga e pamundura arrin të mundurën, pa të cilën, e vërteta e artit poetik, që nga Homeri dhe përtej, nuk do të pranohej si më e besueshmja.

Por unë po i kthehem edhe njëherë detajit – dhembjeveshi i Tursun Pashait, që është zhbirim perfekt i studiuësit drejt skutave të errëta të ndërrijes dhe që, me këtë rast prek çështje të poetikës narrative të Kadaresë; kjo pjesë e tekstit studimor sjell në vëmendje një përbërës, - të pranishëm në mungesë, të Dyzimit, tek romani Rrethimi mes rrëfimitarit (autorit) dhe Pashait osman, të cilit autori do t’i përcjellë një dhimbje veshi, të përsëritur disa herë gjatë rrëfimit; ngasje së cilës nuk ia gjen dot fillin vetë autori i romanit; ai jep e merr në studion e vet, pa mundur ta zgjidh dot enigmën; dhe e merr në dorë studiuësi komplet situatën, bashkë me Kështjellën letrare të Kadaresë, atë të vetërrethuarën së brendshmi, duke zbardhur tërë përkimet ndërtekstore dhe virtuale mes tij dhe Pashait, me një qetësi dhe iluminim të brendshëm. ngjyrimesh të lehta hermeneutike, (edhe pse nuk beson se luan rol tek ky detaj...), të esesë dhe argumentimeve spontane, gërshetim dhe rrjedhë e natyrshme, bërë bashkë; sidomos faqet e studimit brenda nr. 6,7,8,9, ku çdo detaj vihet nën skaner kthjelltësie, ofertë përngjasimesh letrare universale, e studiuësit që nga Xhojsi dhe epeve klasike, argumentim i qetë, pa zjarrmi, pa ngacmime efektuoze që prekin maja besueshmërie

Vizionin krijues të gjeniut Kadare, atë për t’u sjellë shqiptarëve një tjetër Shqipëri, përmes artit romanor, asnjë studiuës më parë nuk e lexon nga një gjerësi dhe lartësi si kjo e Matteo Mandalas; një

Shqipëri paralele, për t'i vënë në hije sundimet perandorike shekujve; t'u sjellë një Shqipëri përmasash antike, homerike, atë që shkëlqen në përjetësi; si vizion, këtë Shqipëri mbase në ndërdije e ka bartur që në rini Kadareja; le të sjellim ndërmend vitet studentore në mjediset moskovitë, zellin për ta sjellë atdheun e vet si vend legjendash e baladash, tragjikisht madhështore, hije rëndë, me kufij antikë dhe përtej, mitologjikë, përballë së tanishme moskovitë dhe tiranase; do ta hetojë dhe përshfaqë këtë fshehtësi ajgëtimi depërtues i Mateos, tek Ankonatët, (1975); ishte hapi i parë drejt projektit, por jo i plotë; e ngushtë fasha kohore, vetëm dy shekuj thellësie, për vizionin madhor të shkrimtarit me këtë rast, pas ndonjë viti prandaj ai do të shkruajë romanin “Ura me tri harqe”, duke vënë këmbë në truallin e lashtësisë etnike dhe duke e lënë të hapur atë, kohën, drejt thellësive; dhe ia doli, edhe duke balancuar tehun e hamendësimeve të rrezikshme për të bërë paralele, edhe të pritët me adhurim nga lexuesi; por që sfida e bërë, do t'i qëndrojë shpatë mbi kokë, i zinte veshi hamendësime të ngjashme, - beson sidomos kur supozon i sigurt Matteo, dhe për ti larguar - thotë gjithnjë Matteo, profanizimeve, gojëligave, mendja zhbiruese kadareane, sjell edhe një alibi: trilogjinë në të cilën bën bashkë romanet: “Ura me tri harqe”, “Pashallëqet e mëdha”, dhe “Muzgu i perëndive të stepës” që edhe kësaj ane teknike, - një bërje bashkë subjektsh asimetrike, nuk i shpëton syrit të studiuesit; “...për të frenuar paralelizmat”.

Të besueshme e sjell simbolikën e imazhit si dyluftim, si betejë mes mësymjes nga jashtë të kështjellës dhe mbrojtjes së saj nga brenda, përplasje-presion paralel, i brendshme i autorit sa për të hequr dorë nga krijimtaria dhe zërit në drejtim të kundërt; qasja ndaj poetikës romanore të Kadaresë është sferë ku shkëlqen Mandala, që e bën të besueshëm në argumentim; që vjen nga një gjerësi formati poliedrik, që spontanisht, natyrshëm, i vijnë asociacione përngjasimi nga përvoja klasike, universal narratologjike; me këtë lehtësi dhe elegancë qasjeje, Matteo do zërë ngoje ndërhyrje, vënie dorë (Përmirësim, thotë Matteo...), nga ana e Kadaresë mbi tekste të caktuar, duke e përmendur kohën-kufi (pas viteve 1990), që është qëndrim sqarues, përcaktues.

PËRFUNDIM DHE MOTIVACIONI PËR NDARJEN E TITULLIT

Duke marrë parasysh faktet e prezentuara më lart si dhe duke konstatuar se Profesor Dr. Mateo Mandala i përmbush të gjitha kriteret formale ligjore dhe statutore të Univeritetit „Nënë Tereza” në Shkup, komisioni recensues në përbërje: Akad. Ali Aliu - kryetar, Akad. Françesko Altimari – anëtar dhe Prof. Dr. Aziz Pollozhani – anëtar, ka nderin dhe kënaqësinë të propozojë Senatit t’i ndajë Titullin Doctor Honoris Causa me këtë motivacion:

“ Për kontribut të shquar në albanologji; në historinë e letërsisë arbëreshe; në filologjinë dhe dialektologjinë arbëreshe; në studimin e korpusit letrar të Ismail Kadaresë; për akribinë, origjinalitetin në tekstologjinë e të shkruarit”

05.08.2021

Komisioni recensues:

Akademik Ali Aliu d.v.

Akademik Françesko Altimari d.v.

Prof. Dr. Aziz Pollozhani d.v.

ФАКУЛТЕТИ И ШКЕНСАВЕ ТЕХНИКЕ / ФАКУЛТЕТ ЗА ТЕХНИЧКИ НАУКИ

РЕФЕРАТ

ЗА ИЗБОР НА НАСТАВНИК ВО СИТЕ НАСТАВНО-НАУЧНИ ЗВАЊА ВО НАСТАВНО-НАУЧНАТА ОБЛАСТ ФИСКАЛНА ЕКОНОМИЈА (50308) НА УНИВЕРЗИТЕТОТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ

Врз основа на конкурсот на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје, објавен во весниците “Коха“ и “Слободен печат“ од 02.07.2021 година, за избор на наставник во сите наставно-научни звања во наставно-научната област **ФИСКАЛНА ЕКОНОМИЈА (50308)** од Класификацијата на научно – истражувачки подрачја, полиња и области според Фраскатиевата класификација и врз основа на Одлуката на Наставно–научниот совет, бр. 02-231/3, донесена на 13.07.2021, формирана е Рецензентска комисија во состав:

Проф. д-р **Агим Мамути**, Редовен професор на Универзитетот “ Мајка Тереза“ - претседател,

Проф. д-р **Петрит Положани**, Професор на Универзитетот во Тетово - член и

Вонр.проф. д-р **Мерале Фетахи- Веапи**, Вонреден професор на Универзитетот во Тетово - член.

Како членови на Рецензентска комисија, по прегледувањето на доставената документација го поднесуваме следниов

ИЗВЕШТАЈ

На објавениот конкурс за избор на наставник во сите наставно-научни звања во научната област **ФИСКАЛНА ЕКОНОМИЈА (50308)**, во предвидениот рок се пријави:

д-р Арбреш Равени.

1. БИОГРАФСКИ ПОДАТОЦИ И ОБРАЗОВАНИЕ

Кандидатката д-р Арбреш Равени е родена на 01.06.1984, во Струга. Средно образование ја завршила во гимназијата “Нико Нестор“ во Струга на 2002 година. Со високо образование се стекнал на Факултетот за бизнис администрација, Универзитет на Југоисточна Европа, на 2006 година. Дипломирала на 2006 година, со просечен успех 9.23.

Кандидатката активно се служи со англискиот јазик.

Во учебната 2008/2009 година се запишала на втор циклус (магистерски) студии на “Staffordshire University“, Велика Британија. Студиите ги завршила на 2010 година, со просечен успех “distinction“. На 2010 година го одбрала магистерскиот труд на тема: “Uncovered Interest Parity in South East European Countries“.

Докторска дисертација ја пријавила на 2012 година на “Staffordshire University“, Велика Британија . Дисертацијата на тема: “Fiscal policy in small open economies in transition- with particular reference to Macedonia” ја одбрала на 2020 година, пред Комисија во состав: Проф.д-р Geoffrey Pugh, Проф.д-р Nick Adnett, Проф.д-р Christofer Gidlow и Проф.д-р Richard Whittle. Со тоа се стекнала со научниот степен доктор на науки од научната област **Фискална Економија**.

На 2010 година е избрана во звањето помлад асистент на Факултетот за економија при Универзитетот во Тетово.

Во моментот е ангажирана како надворешен предавач на Универзитетот Мајка Тереза во Скопје од 01.12.2020 год.

Рецензентската комисија ги имаше предвид вкупните научни, стручни, педагошки и други остварувања на кандидатот од почетокот на кариерата, објавени во билтени, како и вкупните научни, стручни, педагошки и други остварувања на кандидатот од последниот избор до денот на пријавата, врз основа на сета поднесена документација која е од важност за изборот.

2. НАУЧНИ, СТРУЧНИ, ПЕДАГОШКИ И ДРУГИ ОСТВАРУВАЊА НА КАНДИДАТОТ ОД ПОСЛЕДНИОТ ИЗБОР ДО ДЕНОТ НА ПРИЈАВАТА

Наставно-образовна дејност

Во рамките на наставно-образовната дејност на УМТ, кандидатот д-р Арбреш Равени изведува настава, вежби, теренска настава, итн. на прв циклус студии на студиската програма Јавна администрација и менаџирање со човечки ресурси.

Истотака, кандидатката била ангажирана да изведува настава и вежби на прв и втор циклус студии на Економски Факултет при Меѓународниот Универзитет во Струга.

Кандидатката има долгогодишно работно искуство на Економски Факултет при Универзитетот во Тетово каде предаваше предмети од областа на Јавни Финансии.

Други активности кои припаѓаат во наставно-образовната дејност, релевантни за изборот. Конкретните активности се наведуваат во табелата во Прилог, со датуми и други релевантни податоци.

Научноистражувачка дејност/Стручно-уметничка дејност

Д-р Арбреш Равени има објавено вкупно 5 научни трудови од економска област, од кои 4 научни труда во научни списанија со импакт-фактор (фактор на влијание), и 1 труд, во меѓународни научни списанија.

Д-р Арбреш Равени била раководител на 1 национален научен проект, а учествувала како асистент во 1 национален научен проект.

Други активности кои припаѓаат во научноистражувачката дејност, релевантни за изборот. Називите на трудовите, проектите и сл. се наведуваат во табелата во Прилог, со датуми и други релевантни податоци.

Стручно-апликативна дејност и дејност од поширок интерес

Д-р Арбреш Равени активно е вклучена во стручно-апликативната работа, од што може да го истакнеме нејзиното стручно усовршување во странство остварено со студиски престој во Велика Британија.

Особена активност кандидатката покажува во дејностите од поширок интерес.

Кандидатката била ангажирана во различни истражувања, професионални научни обуки, апликативни проекти од различни нивоа организирани од различни организации од областа на економија.

Кандидатот Д-р Арбреш Равени учествувала на повеќе конференции, обуки, проекти и семинари од областа на економијата, внатре и надвор од земјата.

Други активности кои припаѓаат во стручно-апликативната дејност и дејноста од поширок интерес, релевантни за изборот.

Конкретните активности се наведуваат во табелата во Прилог, со датуми и други релевантни податоци.

Оценка од самоевалуација

Кандидатката Д-р Арбреш Равени , на 2021 година, доби позитивна оценка од анонимно спроведената анкета на студентите на Факултетот на социални науки.

ЗАКЛУЧОК И ПРЕДЛОГ

Врз основа на целокупната доставена документација, Рецензентската комисија позитивно ја вреднува и ја оценува наставно - образовната, научноистражувачката и стручно - апликативната дејност, како и дејноста од поширок интерес на д-р Арбреш Равени.

Врз основа на изнесените податоци за севкупната активност на кандидатката од последниот избор до денес, Комисијата заклучи дека д-р Арбреш Равени поседува научни и стручни квалитети и според Законот за високото образование и Правилникот за критериумите и постапката за избор во наставно-научни, научни, наставно-стручни и соработнички звања и асистенти на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје, ги исполнува сите услови да биде избрана во звањето **Доцент** во научната област **ФИСКАЛНА ЕКОНОМИЈА (50308)**.

Според гореизнесеното, Комисијата има чест и задоволство да му предложи на Наставно-научниот совет на Факултетот за технички науки при Универзитет „Мајка Тереза“ во Скопје, д-р Арбреш Равени да биде избрана во звањето **Доцент** во научната област **ФИСКАЛНА ЕКОНОМИЈА (50308)**.

РЕЦЕНЗЕНТСКА КОМИСИЈА

1. Проф. д-р **Агим Мамути**, претседател, с.р.
2. Проф. д-р **Петрит Положани**, член, с.р.
3. Вопр. проф. д-р **Мерале Фетахи- Веапи**, член, с.р.

ПРИЛОГ
КОН ИЗВЕШТАЈОТ ЗА ИЗБОР ВО НАСТАВНО-НАУЧНО, НАУЧНО И НАСТАВНО-СТРУЧНО ЗВАЊЕ

Кандидат: д-р Арбреш Равени

Институција: Универзитетот „Мајка Тереза“ - Скопје

Научна област: ФИСКАЛНА ЕКОНОМИЈА (50308)

НАСТАВНО-ОБРАЗОВНА ДЕЈНОСТ

Ред. број	Назив на активност:	Поени
1	Прв циклус студии на Универзитетот „Мајка Тереза“ - Скопје	
	2020/2021 (непарен семестар) Економија на јавен сектор (4+2)	$4 \times 1 + 1 + 2 \times 0.9 = 6.8$
	2020/2021 (парен семестар) Јавни финансии (4+2)	$4 \times 1 + 1 + 2 \times 0.9 = 6.8$
	2020/2021 (парен семестар) Европска економска интеграција (2+2)	$2 \times 1 + 1 + 2 \times 0.9 = 4.8$
2	Прв циклус студии на Меѓународниот Универзитет во Струга	
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (непарен семестар) Основи на сметководство (3 часа предавање+ 2 часа консултации)	$3 \times (3 \times 1 + 1 + 2 \times 0.2) = 13.2$
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (непарен семестар) Економија на меѓународната трговија (3 часа предавање+ 2 часа консултации)	$3 \times (3 \times 1 + 1 + 2 \times 0.2) = 13.2$
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (непарен семестар) Меѓународни финансиски пазари (3 часа предавање+ 2 часа консултации)	$3 \times (3 \times 1 + 1 + 2 \times 0.2) = 13.2$
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (парен семестар) Девизна политика (3 часа предавање+2 вежби+ 2 часа консултации)	$3 \times (3 \times 1 + 2 \times 0.9 + 1 + 2 \times 0.2) = 15$
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (парен семестар) Јавни финансии (3 часа предавање+ 2 часа консултации)	$3 \times (3 \times 1 + 1 + 2 \times 0.2) = 13.2$
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (парен семестар)	$3 \times (3 \times 1 + 1 + 2 \times 0.2) = 13.2$

	Макроекономија (3 часа предавање+ 2 часа консултации)	
3.	Втор циклус студии на Меѓународниот Универзитет во Струга	
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (непарен семестар) Меѓународни финансиски менаџмент (4 часа предавање+2 вежби+ 2 часа консултации)	$3 \times (4 \times 3 + 2 \times 0.9 + 1 + 2 \times 0.2) = 45.6$
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (парен семестар) Организациско однесување (4 часа предавање+2 вежби+ 2 часа консултации)	$3 \times (4 \times 3 + 2 \times 0.9 + 1 + 2 \times 0.2) = 45.6$
	2017/2018, 2018/2019, 2019/2020 (парен семестар) Менаџмент на инвестиции (4 часа предавање+2 вежби+ 2 часа консултации)	$3 \times (4 \times 3 + 2 \times 0.9 + 1 + 2 \times 0.2) = 45.6$
4.	Прв циклус студии на Универзитетот во Тетово	
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (непарен семестар) Вовед во економија (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (непарен семестар) Претприемништво (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (непарен семестар) Економетрија 1 (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (непарен семестар) Макроекономија 1 (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (парен семестар) Микроекономија 1 (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (парен семестар) Јавни финансии (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (парен семестар) Макроекономија 2 (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	2009/2010, 2010/2011, 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, 2015/2016 (парен семестар) Економетрија 2 (2 часа вежби)	$7 \times (2 \times 0.9) = 12.6$
	Вкупно	323.8

НАУЧНОИСТРАЖУВАЧКА ДЕЈНОСТ

Ред. број	Назив на активноста:	Поени
1.	Одбранета докторска теза - 15 април 2020 “Fiscal policy in small open economies in transition- with particular reference to Macedonia”, Staffordshire University	8
2.	Одбранета магистерска теза - Јуни, 2010 “Uncovered Interest Parity in South East European Countries“, Staffordshire University	4
3.	Раководител на национален научен проект , Јуни-Декември, 2010 “Promoting young entrepreneurs-support of job creation programme in Struga”, Center for development and Integration (CDI)	6
4.	Учесник на национален научен проект , Јан.-Април, 2011 “Youth work development in Macedonia”, PPC Gostivar	3
5.	Трудови со оригинални научни резултати, објавен во референтно научно/стручно списание со меѓународен уредувачки одбор индексирано во мултидисциплинарни бази на податоци	
	Raveni, A., (2021) “ A Meta-Regression analysis on the size of fiscal multipliers ”, <i>South East European Journal of Sustainable Development</i> , vol.5 (3/2021), 112-131, ISSN 2545-4463	6
	Raveni, A., (2021) “ The determinants of fiscal multipliers in transition countries: a Panel VAR model ”, <i>South East European Journal of Sustainable Development</i> , vol.5 (3/2021), 132-147, , ISSN 2545-4463	6
	Raveni, A., (2021) “ Estimating fiscal multipliers for North Macedonia: a Structural Vector Error Correction model ”, <i>CIT Review Journal</i> , May Issue, 64-75, ISSN 2523-6962	6
	Raveni, A., (2021), “ The transmission mechanism of fiscal policy in North Macedonia: a Bayesian VAR approach ”, <i>Academic Journal of Business Administration, Law and Social Sciences</i> , vol.7 (2), ISSN 2410-3918	6
6	Труд со оригинални научни резултати, објавен во стручно/научно популарно списание со меѓународен уредувачки одбор	
	Raveni, A., (2021), “ Labour market flexibility in transition countries: a case study of North Macedonia ”, <i>Iliria International Review</i> , vol.11 (1) ISSN 2192-7081	3
7	Апстракт објавен во зборник на конференција	
	A.Mamudi, “ Uncovered Interest rate parity in SEE countries revisited ”- presented at ISCFE, 2016, University of Tetovo,	1
	A.Mamudi & G.Pugh, “ Fiscal Multipliers: A meta regression analysis ” - presented at MAER-Net 2014 Athens Colloquium	1
	Вкупно	50

СТРУЧНО - АПЛИКАТИВНА ДЕЈНОСТ

Ред. Број	Назив на активноста:	Поени
1	Експертски активности: евалуација, стручна ревизија, супервизија, проценка на капитал, систематизација, методологија	
	Евалуација на странска приватна компанија	1
2	Идеен проект	
	учесник/соработник на проект на странска приватна организација	1
3	Студија, физибилити студија, истражување на пазарот	
	Физибилити студија- одговорен проектант, странска приватна компанија	2
	истражување на пазарот- одговорен проектант, странска приватна компанија	2
4	Главен (основен) проект	
	“Promoting young entrepreneurs“- одговорен проектант	4
Дејности од поширок интерес		
5	Студиски престој во странство повеќе од 6 месеци	
	Магистерски и докторски студии- Велика Британија	4
6	Награда за научни постигнувања од струкова организација	
	OSF-Staffordshire University стипендија за магистерски студии	3
	OSF-Staffordshire University стипендија за докторски студии	3
	Вкупно	20

ПРОФЕСИОНАЛНИ РЕФЕРЕНЦИ НА КАНДИДАТОТ ЗА ИЗБОР ВО ЗВАЊЕ	Поени
НАСТАВНО-ОБРАЗОВНА ДЕЈНОСТ	323.8
НАУЧНОИСТРАЖУВАЧКА ДЕЈНОСТ	50
СТРУЧНО-АПЛИКАТИВНА ДЕЈНОСТ	20
Вкупно	393.8

РЕЦЕНЗЕНТСКА КОМИСИЈА

1. Проф. д-р **Агим Мамути**, претседател, с.р.
2. Проф. д-р **Петрит Положани**, член, с.р.
3. Вонр. проф. д-р **Мерале Фетахи- Веапи**, член, с.р.

**FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNOLOGJIKE / ФАКУЛТЕТ ЗА ТЕХНОЛОШКИ
НАУКИ**

REFERAT

**PËR ZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË THIRJE DOCENT NGA FUSHA
MËSIMORE-SHKENCORE TEKSTIL (60707) TË UNIVERSITETIT „NËNË TEREZA” NË
SHKUP**

Në bazë të konkursit të Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup, të shpallur në gazetën „Koha” dhe „Слободен печат” me datë 01.07.2021, për zgjedhje të një mësimitdhënësi në thirje Docent nga fusha mësimore – shkencore TEKSTIL (60707) nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit dhe në bazë të Vendimit të Këshillit mësimor-shkencor, nr. 02-233/1 të sjellë me datë 13.07.2021, formohet Komisioni recensues në përbërje të:

Mr Nevenka Todorovska, docent në Universitetin „Nënë Tereza” -Shkup - kryetar,

Dr.Igor Shokarovski, profesor inordinar në Universitetin „FON” - anëtar dhe

Mr. Kushtrim Bektashi, profesor inordinar në Universitetin e Tetovës - anëtar.

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas kontrollimit të dokumentacionit të dorëzuar paraqesim këtë

RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje të një mësimitdhënësi në thirje Docent nga fusha mësimore – shkencore TEKSTIL (60707), në afatin e paraparë u paraqit/ën:

Mr Emira Imeri.

1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE TË SHKOLLIMIT

Kandidati/ja Mr.Emira Imeri është i/e lindur me 19.05.1992, në Kumanovë. Shkollimin e mesëm e kreu „Sami Frashari” në 2011. Arsimin e lartë e kreu në Universitetin „FON”, në vitin 2017. Diplomoi në vitin 2017, me notë mesatare 8,75.

Kandidati/ja në mënyrë aktive përdor gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze.

Në vitin akademik 2017 u regjistrua në ciklin e dytë (të magjistraturës) të studimeve në Universitetin „FON”, në drejtimin dizajn dhe multimedia. Studimet i përfundoi në vitin 2020, me notë mesatare 9,55. Në vitin 2020 mbrojti temën e magjistraturës me titull: Moda si aksesuar i karakterit.

Komisioni recensues kishte parasysh realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike dhe realizime të tjera të kandidatit prej fillimit të karrierës, si dhe realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike dhe realizime të tjera të kandidatit nga zgjedhja e fundit deri në ditën e paraqitjes, në bazë të gjithë dokumentacionit të dorëzuar që i rëndësishme për zgjedhjen.

**2. REALIZIMET SHKENCORE, PROFESIONALE, PEDAGOGJIKE TË KANDIDATIT NGA ZGJEDHJA
E FUNDIT DERI NË DITËN E PARAQITJES**

Veprimtaria edukativo-arsimore

Në kuadër të veprimtarisë edukativo-arsimore të UNT-së, kandidati/ja Mr Emira Imeri, mbanëushtrime, mësim në teren etj. në ciklin e parëtë studimeve në programin studimor Tekstil, dizajn dhe modelim.

**Aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë edukativo-arsimore, relevante për zgjedhjen.
Aktivitetet konkrete paraqiten në tabelarin në Shtojcë, me datë dhe të dhëna tjera relevante**

Veprimtaria kërkimore-shkencore/ Veprimtaria profesionale-artistike

Mr Emira Imeri gjithsej ka prezentuar 7 ekspozita nga fusha e dizajnit.

Mr Emira Imeri ishte bashkëpunorë në 4 projekte kombëtare.

Aktivitete tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë kërkimore-shkencore, relevante për zgjedhjen.

Titujt e punimeve, projekteve etj. Paraqiten në tabelorin në Shtojcë, me datë dhe të dhëna tjera relevante.

Veprimtaria profesionale-aplikative dhe veprimtaria me interes më të gjerë

Mr Emira Imeri në mënyrë aktive është e/i kyçur në veprimtarinë profesionale-aplikative nëfushën e tekstilit, dizajnit dhe kostumografisë.

Ka realizuar përsosshmëri profesionale jashtë vendit gjatëqëndrimit studentor në Paris.

Aktivitete tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale-aplikative dhe veprimtarinë e interesit më të gjerë, relevante për zgjedhjen.

Aktivitetet konkrete paraqiten në tabelën në Shtojcë, me datë dhe të dhëna tjera relevante.

Vlerësim nga vetëevaluimi

Kandidatja Mr Emira Imeri, në vitin 2020, morri vlerësim pozitiv nga një anketë e zhvilluar në mënyrë anonime nga studentët e Fakultetit të Shkencave teknologjike.

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të dokumentacionit të përgjithshëm të dorëzuar dhe njohjes personale të kandidatit, Komisioni recensues në mënyrë pozitive vlerëson dhe noton veprimtarinë edukativo-arsimore, kërkimore-shkencore dhe profesionale-aplikative, si dhe veprimtarinë e interesit më të gjerë të Mr Emira Imeri.

Në bazë të të dhënave të paraqitura për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit nga zgjedhja e fundit deri më sot, Komisioni përfundoi se Mr Emira Imeri ka kualitete profesionale dhe shkencore dhe sipas Ligjit për arsim të lartë dhe Rregullores për kriteret dhe procedurës për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale, dhe thirrje të bashkëpunëtorëve dhe asistentëve- doktorantëve në Universitetin „Nënë Tereza” në Shkup, i plotëson të gjitha kushtet për zgjedhje në thirrjen Docent në fushën shkencore Tekstil (60707).

Sipas të lartpërmendurës, Komisioni ka nder që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave teknologjike pranë Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup t’i propozojë, Mr.Emira Imeri të zgjidhet në thirrjen Docent në fushën shkencore Tekstil (60707).

KOMISIONI RECENSUES

1. Mr Nevenka Todorovska, docent në Universitetin „Nënë Tereza“-Shkup - kryetar, d.v.
2. Dr. Igor Shokarovski,profesor inordinar në Universitetin“FON” – anëtar d.v. dhe
3. Mr. Kushtrim Bekteshi,profesor inordinar në Universitetin e Tetovës – anëtar d.v.

SHTOJCA DREJT RAPORTIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN EDUKATIVO-ARSIMORE, MËSIMORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Emira Imeri

Institucioni: Fakulteti i Shkencave teknologjike pranë Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup

Fusha shkencore: Tekstil (60707)

VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
	Mbajtja e ushtrimeve	
	Teknikat e modelimit dhe qepjes (2018/2019) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+2	0.9
	Teknikat e prerjes dhe qepes (2018/2019) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+1	0.45
	Koncepti I dizajnit vizuel (2019/2020) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+2	0.9
	Studio creative (2019/2020) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+2	0.9
	Fotografi mode dhe teknikat e ekspozitës (2019/2020) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+1	0.45
	Kerkim I modes dhe frymezim (2019/2020) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+1	0.45
	Histori e veshjeve dhe dizajnit dhe tendencat avant-garde ne art (2020/2021) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+2	0.9
	Standardet dhe rregulloret per marken edizajnit(2020/2021) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+2	0.9
	Teknikat e modelimit dhe qepjes (2019/2020) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+2	0.9
	Teknikat e prerjes dhe qepjes (2019/2020) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+1	0.45
	Ilustrim mode (2020/2021) në drejtimin Tekstil, dizajn dhe modelim, 2+1	0.45
	Mesimdhenie ne shkolla, punetori dhe seminare	
	“Full professional Design&Architecture”-Winter school,Bertone design academy,Italy	1
	Mesimdhenie ne teren	
	Prezentim I kreacioneve te studenteve ne Qytetin e Shkupit-mesimdhenes	1.5
	Prezentim I koleksionit ne qytetin e Zvicres, Basel-pjesmarres	1
	Prezentim dhe realizim I fotosesionit te koleksionit te modes ne hapsirat e qytetit te Baselit	1
	Pergatitje dhe hyrje ne lenden e re	
	Kerkim I modes dhe frymezim-ushtrime	1

	Krijim I rrobave me art dhe dizajn bashkekohor-ushtime	1
	Ilustrim I modes	1
	Fotografia ne mode dhe teknikat e ekspozites	1
	Konsultime me studentet	
	Kerkim I modes dhe frymezim-ushtime	0.2
	Krijim I rrobave me art dhe dizajn bashkekohor	0.1
	Ilustrim I modes	0.1
	Fotografia ne mode dhe teknikat e ekspozites	0.1
	Gjithsej	16.65

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
	Bashkepunetor ne projekte nacionale	
	Kostumografe në shfaqjen teatrale „Ves Ves“ produksion i IN Teatri i Gostivarit, 2020	3
	Kostumografe-Film i metrazhit te shkurt 2018	3
	Kostumografe- Reklame e brandit RC Cola	3
	Kostumografe-Tregime popullore, episodi I dhe II („Besa“ dhe „Nderi“), Frame in production 2020/2021	6
	Gjithsej	15

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ARTISTIKE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
	Kurator I ekspozites ne fushen e dizajnit te modes	
	Prezentim I Koleksionit te modes “Heyoka” Pranvere/vere 2017	2
	Prezentim public kolektiv I punes creative ne fushen e dizajnit.	
	Ekspozite kolektive-mesimdhenes, 2021-Daut Pasha, UNT	2
	Ekspozite kolektive-pjesmarres, KumanovART, 2018	2
	Ekspozite kolektive-pjesmarres, Skopje Creativa, Mode 2015	2
	Ekspozite kolektive e Institutit Internacional te Modes, Izet Curi-pjesmarres, 2015	2
	Prezentim I koleksionit Pranvere/Vere 2015, Hollywood Era	2
	Gjithsej	12

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
	Pjesmarrje ne aktivite promovuese ne Fakultetin e Shkencave teknologjike	
	Ne periudhen 2018,2019,2020,2021	2

	Punime ne fushen e dizajn dhe multimedija	
	Autor-Film I shkurter mode 2018	2
Veprimtari e interesit më të gjerë		
	Qendrim studimor ne vende te huaja	
	Fashion Federation, Paris Advanced professionals in Fashion, Paris Styliste&Modeliste, 2013	1.5
	Gjithsej	5.5

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE	Pikët
VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE	16.65
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	15
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ARTISTIKE	12
VEPRIMTARIA PROFESIONALE- APLIKATIVE	5.5
Gjithsej	49.15

KOMISIONI RECENSUES

1. Mr Nevenka Todorovska, docent në Universitetin „Nënë Tereza“-Shkup – kryetar d.v.
2. Dr. Igor Shokarovski, profesor inordinar në Universitetin “FON” – anëtar d.v. dhe
3. Mr. Kushtrim Bekteshi, profesor inordinar në Universitetin e Tetovës – anëtar d.v. .